



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

STRATEGJIA E NDËRKOMBËTARIZIMIT FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



Miratuar me Vendimin e Dekanatit

Nr. 150 datë 21.12.2021

Dhjetor 2021





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

Përmbajtja

Hyrje.....	3
Përse një strategji ndërkombëtarizimi për Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës?	3
KREU I. MISIONI, VIZIONI, PRIORITETET DHE OBJEKTIVAT E STRATEGJISË SË NDËRKOMBËTARIZIMIT TË FAKULTETIT TË GJUHËVE TË HUAJA	6
1.1. Misioni	6
1.2. Vizioni	7
1.3. Përcaktimi i prioriteteve në nivel Njësie Kryesore	8
1.4. Objektivat dhe orientimet kryesore të Strategjisë së Ndërkombëtarizimit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja	9
1.4.1. Objektivi Nr.1: Ndërkombëtarizimi i mjedisit të të Mësuarit (ndërkombëtarizimi në shtëpi)	9
1.4.2. Objektivi Nr.2: Ndërkombëtarizimi i institucionit;	15
1.4.3. Objektivi Nr.3: Ndërkombëtarizimi i kërkimit shkencor;	26
1.4.4. Objektivi Nr.4: Krijimi dhe fuqizimi i rrjetit ndërkombëtar të FGJH- Alumni;	31
1.5. Treguesit dhe rezultatet e pritshme	33
KREU II. ANALIZË E SITUATËS SË NDËRKOMBËTARIZIMIT NË FGJH	34
2.1. Analizë e gjendjes aktuale - ANALIZA SWOT	34
2.2. Analizë e situatës mbi bashkëpunimet me partnerë vendas dhe të huaj gjatë 3 viteve të fundit.	36
2.3. Projekte të përbashkëta me universitete/institucione të huaja për çdo departament	39
2.4. Programe të formimit të përbashkëta me universitete të huaja.	46
2.5. Konstatime dhe përfundime	46
KREU III. PLANE VEPRIMI TË STRATEGJISË SË NDËRKOMBËTARIZIMIT TË FAKULTETIT TË GJUHËVE TË HUAJA NË NIVEL NJËSIE BAZË	48
3.1. Plan Veprimi Departamenti i Gjuhës Angleze	49
3.2. Plan Veprimi Departamenti i Gjuhës Frënge	58
3.3. Plan Veprimi Departamenti i Gjuhës Gjermane	60
3.4. Plan Veprimi Departamenti i Gjuhës Spanjolle	63
3.5. Plan Veprimi Departamenti i Gjuhëve Sllavo-Ballkanike	65
3.5.1. Dega e Gjuhës Turke	65
3.5.2. Dega e Gjuhës Ruse	68
3.6. Plan Veprimi Departamenti i Gjuhës Italiane	73
3.7. Plan Veprimi Departamenti i Gjuhës Greke	78





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I TIRANËS

FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

KREU IV. ZBATIMI, RAPORTIMI, MONITORIMI, VLERËSIMI I STRATEGJISË SË NDËRKOMBËTARIZIMIT TË FAKULTETIT TË GJUHËVE TË HUAJA	81
4.1. Zbatimi	81
4.2. Raportimi dhe komunikimi	81
4.3. Monitorimi	82
4.4. Vlerësimi.....	82
Përfundime.....	85
Referenca dhe bibliografi.....	86





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



Hyrje

Përse një strategji ndërkombëtarizimi për Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës?

Dekadat e fundit bota ka qenë në ndryshim të vazhdueshëm dhe ky ndryshim po ndodh gjithnjë e më shpejt. Bota është bërë tanimë globale, më e ndërlidhur në sajë të zhvillimit teknologjik ku edhe nocioni i kufijve duket disi më i zbehur. Në këtë kontekst ndryshimesh edhe sfera e arsimit të lartë është duke u ravijëzuar brenda një kuadri sa global aq edhe gjithëpërfshirës. Universiteteve shqiptare u ka dalë si detyrë themelore edhe integrimi i strategjive të ndërkombëtarizimit brenda strategjive të tyre zhvillimore institucionale.

Në vijim të thirrjes së Universitetit të Tiranës, i cili sikundër të gjithë institucionet e tjera të arsimit të lartë në Shqipëri, ndërmori nismën e hartimit të Strategjisë së Ndërkombëtarizimit, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja reagoi menjëherë dhe u angazhua tërësisht në hartimin e strategjisë në nivel fakulteti, duke mbledhur së bashku të gjithë përfaqësuesit e grupit të punës në nivel njësie bazë për të diskutuar, analizuar situatën aktuale, hedhur ide, evidentuar pikat e forta dhe mangësitë, planifikuar veprime konkrete, hartëzuar aktorët, ndarë punën në ndihmë të hartimit të një strategjie bashkëkohore e të unifikuar në nivel universiteti. Pas përcaktimit të agjendës së takimeve, u zhvilluan disa takime mes grupeve të punës në nivel fakulteti ku u shkëmbyen ide e diskutime konstruktive.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja i Universitetit të Tiranës, bashkëngjit Strategjinë e tij të Ndërkombëtarizimit ndaj Strategjisë së Ndërkombëtarizimit të Universitetit të Tiranës, strategji e cila do të zbatohet si brenda vendit, nëpërmjet ndërkombëtarizimit të programeve studimore, trajnimit të ofruar në vazhdimësi, ashtu edhe në skenën ndërkombëtare, përmes zhvillimit të partneriteteve dhe shkëmbimeve me universitetet e tjera në veçanti.

Në aspektin e integritit në BE, Strategjia e Ndërkombëtarizimit të FGJH-së 2021 -2026 është në koherencë të plotë me objektivat strategjike të kornizës Edukimi & Trajnimi 2020 për bashkëpunim midis vendeve të Bashkimit Evropian në fushën e arsimit dhe të formimit, me Kuadrin e ri të BE-së për kompetencat kyçe për të nxënësit gjatë gjithë jetës, si edhe me objektivin OZHQ 4 të Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm.

Strategjia e Ndërkombëtarizimit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja mbështetet në Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Neni 1 Misioni i arsimit të lartë Arsimi i lartë është e mirë dhe përgjegjësi publike dhe ka për mision: Gërma e) të nxisë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit të lartë.

Kjo Strategji është gjithashtu në përputhje me Kornizën Evropiane të Edukimit & Trajnimit 2020 e cila parashikon katër objektiva strategjike për bashkëpunim midis vendeve të Bashkimit Evropian në fushën e arsimit dhe të edukimit:

- 1) Bërja realitet e të nxënësit gjatë gjithë jetës dhe mobilitetit;
- 2) Përmirësimi i cilësisë dhe efikasitetit të arsimit dhe formimit;
- 3) Nxitja e barazisë, kohezionit social dhe qytetarisë aktive; dhe
- 4) Shtimi i kreativitetit dhe inovacionit, përfshirë sipërmarrjen, në të gjitha nivelet e arsimit dhe formimit.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

Strategjia mbështetet edhe në Statutin e Universitetit të Tiranës, 2018, Neni 8. Zhvillimi i veprimtarisë, pika 3. UT-ja e zhvillon veprimtarinë e vet brenda sistemit universitar e të kërkimit shkencor kombëtar dhe ndërkombëtar në kuadër të detyrimeve me karakter integruar, apo në realizim të marrëveshjeve ndërkombëtare, dhe 4. UT-ja konsideron detyrë themelore të mësuarit, studimit dhe kërkimit shkencor, në bashkëpunim me institucionet vendase dhe nëpërmjet shkëmbimit ndërkombëtar të pedagogëve e të studentëve, në përmbushje të objektivave dhe të programeve të veta.

Strategjia e përgatitur në nivelin e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja është konceptuar e ndarë në 4 (katër) krerë të cilët janë harmonizuar duke nisur me Hyrjen në të cilën paraqiten arsyet për hartimin dhe zhvillimin e një strategjie ndërkombëtarizimi për FGJH-në, duke vijuar me Kreun I Misioni, vizioni, prioritetet dhe objektivat e Strategjisë së Ndërkombëtarizimit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, në të cilin parashtrohet misioni, vizioni si edhe prioritetet mbi bazën e të cilave do të përvijohen objektivat e strategjisë së ndërkombëtarizimit.

Kreu II ndalet tek analiza e situatës aktuale të ndërkombëtarizimit në FGJH e cila mbështetet në analizën SWOT, analizën e bashkëpunimeve me partnerë të huaj gjatë tri viteve të fundit, projektet e përbashkëta me universitete të huaja të arsimit të lartë.

Në Kreun III përcaktohen Planet e veprimit të Strategjisë së Ndërkombëtarizimit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, në Nivel Njësie Bazë, përkatësisht planet e veprimit të departamenteve të: gjuhës angleze, frënge, gjermane, spanjolle, italiane, greke, sllave dhe ballkanike me degët e tyre të gjuhës turke dhe ruse.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

Kreu IV përfshin të gjitha përfshin elemente që lidhen me raportimin dhe komunikimin, monitorimin, vlerësimin dhe ndjekjen e zbatimit të strategjisë së ndërkombëtarizimit.

Strategjia përmbyllet me përfundimet e përftuara në kuadër të hartimit të strategjisë për ndërkombëtarizimin si edhe me bibliografinë përkatëse.

KREU I. MISIONI, VIZIONI, PRIORITETET DHE OBJEKTIVAT E STRATEGJISË SË NDËRKOMBËTARIZIMIT TË FAKULTETIT TË GJUHËVE TË HUAJA

1.1. Misioni

Në qendër të misionit tonë është hapja ndaj botës e studentëve tanë, personelit akademik dhe atij ndihmës-akademik, si edhe e programeve tona. Bashkëpunimi ndërkombëtar ose ndërkombëtarizimi lejon shkëmbimin e ideve dhe bashkëpunimeve të dobishme në mënyrë të ndërsjellë dhe shfaqet si një domosdoshmëri për konsolidimin e dimensionit ndërkombëtar të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja

Ndërkombëtarizimi nuk duhet konceptuar si një produkt a përpjekje individuale. Në frymën e bashkëpunimit, ai duhet të zhvillohet në një qasje të përbashkët e gjithëpërfshirëse ku, objektivat, prioritetet, planet e veprimit dhe rezultatet e pritshme hartohen e zbatohen nga Asambleja e Pedagogëve, brenda Njësive Bazë ku zhvillohet veprimtaria mësimore e kërkimore përkatëse, në bashkërendim me struktura të ndryshme të Universitetit të Tiranës (akademike dhe administrative).





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

Cilët janë aktorët e drejtpërdrejtë të ndërkombëtarizimit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja?

- Studentët;
- Personeli akademik, studiuesit dhe kërkuesit shkencorë;
- Stafi ndihmës-akademik, administrativ dhe teknik;
- Alumni.

Objektivat prioritare të kësaj strategjie përfshijnë por nuk kufizohen në:

- përgatitjen e studentëve për detyrat e tyre të ardhshme në këtë botë të globalizuar;
- lehtësimin e marrëdhënieve që lidhin kërkuesit shkencorë në shkallë ndërkombëtare, veçanërisht në kuadrin e partneriteteve strategjike ose përgjigjen ndaj sfidave me të cilat përballet shoqëria.

1.2. Vizioni

Fuqizimi i institucionit FGJH ku dija dhe kërkimi shkencor të jenë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, shoqëror dhe kulturor të kohës.

Bashkimi i energjive të brendshme të stafit akademik, ndihmës-akademik, administrativ dhe të studentëve të fakultetit në bashkëpunim me të gjitha njësitë dhe strukturat përbërëse të Universitetit të Tiranës.

Ndërkombëtarizimi i mëtejshëm i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja në nivel rajonal dhe ndërkombëtar në mënyrë që ai të jetë një zgjedhje e parapëlqyer për studentët vendas dhe të huaj.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

1.3. Përcaktimi i prioriteteve në nivel Njësie Kryesore

Ndërkombëtarizimi i kurrikulës dhe i procesit të mësimdhënies dhe të nxënit si edhe ofrimi i programeve dhe diplomave të përbashkëta është një ndër prioritetet kryesore të strategjisë zhvillimore të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja. Për nga vetë rëndësia e këtij komponenti, veprimet që do të ndërmerren e brendashkruhen objektivave dhe orientimeve kryesore të Strategjisë së Ndërkombëtarizimit të FGJH-së, përfshijnë, por nuk kufizohen në këto veprime:

- Përfshirja e koncepteve kryesore të qytetarisë globale në përvojën e të nxënit të studentëve tanë dhe parimet e drejtësisë shoqërore, ekologjisë qytetare, zhvillimit të qëndrueshëm, garës së drejtë, kohezionit me komunitetin dhe shkëmbimit global; duhet të përshkojnë politikat dhe praktikat tona arsimore në të gjitha nivelet;
- Integrimi i kompetencave globale dhe ndërkulturore në kurrikula;
- Zhvillimi i burimeve të mësimit elektronik për të mbështetur ndërkombëtarizimin dhe për të promovuar ndërgjegjësimin për çështjet globale të arsimit;
- Ofrimi i programeve të përbashkëta me universitetet e huaja - Fuqizimi i Masterit të Përkthimit me Strasburgun;
- Promovimi dhe mbështetja e mundësive ndërkombëtare për studentët, duke përfshirë mundësitë afatshkurtra për studentët tanë për të studiuar në universitetet partnere, për internshpet ndërkombëtare dhe shkollat verore;
- Promovimi i mundësive për shkëmbimin e studentëve të ofruara nga Programet e Bashkimit Evropian, si Erasmus⁺, Programet e Përbashkëta Master, Partneritetet Erasmus Mundus, programet dypalëshe të vendeve ose programe të tjera ndërkombëtare;
- Ofrimi i mundësive për stafin akademik për të marrë pjesë në aktivitetet ndërkombëtare;
- Organizimi i të paktën një konference ndërkombëtare në vit;





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

- Zgjerimi i lidhjeve me partnerët strategjikë të kërkimit nëpërmjet rrjeteve universitare;
- Tërheqja e studentëve ndërkombëtarë dhe mbështetja e tyre që ata të bëhen pjesë e komunitetit tonë.

1.4. Objektivat dhe orientimet kryesore të Strategjisë së Ndërkombëtarizimit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja

Katër janë objektivat dhe prioritetet kryesore strategjike:

- 1- Ndërkombëtarizimi i mjedisit të të Mësuarit (ndërkombëtarizimi në shtëpi);
- 2- Ndërkombëtarizimi i institucionit;
- 3- Ndërkombëtarizimi i kërkimit shkencor;
- 4- Krijimi dhe fuqizimi i rrjetit ndërkombëtar të FGJH Alumni.

1.4.1. Objektivi Nr.1: Ndërkombëtarizimi i mjedisit të të Mësuarit (ndërkombëtarizimi në shtëpi)

Nr.	Veprime	Rezultate	Aktorët	Afatet
1.1. Ndërkombëtarizimi i Kurrikulës	1.1.1 Hapje e programeve në gjuhën angleze në çdo fakultet të UT	-Programe në çdo departament që ofrohen në gjuhën angleze kryesisht, apo gjuhë të	FGJH- Njësitë Bazë	Realizuar





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

dhe rritja e cilësisë së ligjërimit në gjuhë të huaj për programet që tashmë ofrohen në gjuhë të huaj	huaj tjetër (p.sh. Italisht, etj) nga pedagogët e UT-së.		
1.1.2 Sensibilizimi i personelit për ndërkombëtarizimin përmes trajnimeve, etj.	-Trajnime të zhvilluara mbi ndërkombëtarizimin dhe çështjet multi kulturele	UT, FGJH Zyra IRO dhe Marrëdhëniet me jashtë	2 vite
1.1.3 Promovim i programeve studimore përmes kanaleve të ndryshme të marketimit	Ofertë e dukshme, atraktive e promovuar në website, faqe zyrtare të facebook, media, etj.	UT, FGJH Zyra IRO dhe Marrëdhëniet me Publikun	2 vite
1.1.5 Ofrimi i programeve të përbashkëta	- Programe të përbashkëta, të diplomave të dyfishta, shumëfishta, të delokalizuar me partnerët strategjik. -Udhëheqje e përbashkët e tezave PHD	Njësitë bazë	





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

	1.1.6 Promovimi i programeve të përbashkëta aktuale që ofrohen në kuadër të marrëveshjeve ekzistuese për diploma të dyfishta, të projekteve ndërkombëtare, të marrëveshjeve shumëpalëshe, etj.	Program vizibël, atraktiv dhe promovuar në <i>website</i> , faqe zyrtare të <i>facebook</i> , media, etj.	Njësitë Bazë Zyra IRO Marrëdhëniet me publikun	5 vite
	1.1.7 Programet e reja të studimit që do të ofrohen në FGJH të hartohen me një objektiv të dyfishtë: për të adresuar kontekstin kombëtar por edhe për të siguruar koherencë përballë programeve të ngjashme të studimeve në Evropë.	<ul style="list-style-type: none">- Kurrikula të përmirësuara, të përshtatura me përvojat më të mira ndërkombëtare, ashtu dhe me zhvillimet në ekonominë kombëtare.- Programe të reja të studimit, bazuar në përvojat më të mira ndërkombëtare. Kjo përvojë sugjeron hapjen e programeve		5 vite






REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

		mikse/ndwrdisiplinare të studimit si një rrugë efikase për t'iu përshtatur më mirë tregut të punës.		5 vite
	1.1.9 Rritja e numrit të pedagogëve të huaj që japin mësim në FGJH-UT			
	1.1.10 Krijimi i një oferte tërheqëse për programe afatshkurtra	<ul style="list-style-type: none">- Vazhdimësi e ofertës së Shkollave verore dhe dimërore- Zhvillimi i javës/javëve integruese në fillim të çdo semestri		

Njësitë bazë





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

			Njësitë bazë	5 vite
				5 vite
	Përshtatja e kurrikulës me ndryshimet dhe sfidat në nivel global.	-Rishikimi i kurrikulës sipas disiplinave - Kurrikula reflekton sfidat globale dhe orientohet drejt përgatitjes së studentëve për t'i adresuar sfidat	Njësitë bazë	3 vite
1.2. Ndërkombëtarizimi i mjediseve universitare	1.2.1 Përmirësimi i vazhdueshëm i ambienteve të Fakultetit (auditorë,	-Infrastrukturë moderne dhe laboratorë që përputhen me kërkesat dhe nevojat e	Administrato ri	3 vite





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

	laboratorë, etj), me infrastrukturë moderne dhe në përputhje me standardet europiane.	programeve tona studimore.		
	1.2.3 Pasurim i bilibliotekës virtuale me literaturë kombëtare dhe ndërkombëtare.		Administrato ri	5 vite
	1.2.4 Zhvillimi i aktiviteteve (me bazë departamentin ose fakultetin), të cilat vënë theks në zhvillimet ndërkombëtare	-Rritje e vizibilitetit të Fakultetit -Fuqizim i dimensionit ndërkombëtar	Njësia Bazë Njësia kryesore Zyrat IRO+MN	5 vite





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



1.4.2. Objektivi Nr.2: Ndërkombëtarizimi i institucionit;

Nr.	Veprime	Rezultate	Aktorët	Afatet
2.1 Rritja e numrit të marrëveshjeve bilaterale, MoU 2.2 Marrëveshje binjakëzimi midis fakulteteve/njësi bazë			Zyra IRO – UT, Zyra e MN në FGJH Njësitë bazë Pedagogët	5 vite
2.3 Zgjerimi i gamës së partnerëve dhe marrëveshjeve ndërinstitucionale në kuadër të programit Erasmus + 2.4 Organizimi i aktiviteteve me karakter ndërkombëtar 2.5 Anëtarësimi në rrjete të reja ndërkombëtare dhe	2.1.1 Të rritet numri i marrëveshjeve me universitetet e BE-së dhe jo vetëm për çështje me interes të përbashkët, si mobilitete për stafin akademik/administrativ, mobilitet i studentëve, organizim i aktiviteteve të përbashkëta, ofrimi i praktikave apo stazheve, etj. Po ashtu të parashikohet dhe	-Numër i lartë i marrëveshjeve dhe intensifikim i shkëmbimeve të stafit dhe studentëve. -Fond i dedikuar për mobilitetin e studentëve dhe stafit për arsye studimore, trajnimi, kualifikimi.	Zyra IRO – UT, Zyra e MN në FGJH Njësitë bazë Pedagogët	5 vite





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

sigurimi i pjesëmarrjes aktive në to	mobiliteti hyrës i stafit të huaj apo studentëve të huaj.			
2.6 Përforcimi i komunikimit dhe qënderzimi i informacionit brenda UT-së	2.1.2 Rritje e mobiliteteve afatshkurtra, më pak se një semestër			
2.7 Shpërndarja e informacionit te komuniteti universitar	2.1.3 Pjesëmarrje në sallone studimesh			
2.8 Konsolidim i vizibilitetit të FGJH-së UT-së jashtë vendit	2.1.4 Zhvillimi i programit Ambasador i mobilitetit.			
2.9 Fuqizimi i strukturës për kërkimin shkencor, projektet dhe marrëdhëniet me jashtë	2.1.5 Ofrimi i mbështetjes financiare për studentët që zhvillojnë mobilitet jashtë ndonjë programi të financuar nga BE dhe që lëvizin si freemover			
	2.1.6 Zbatimi i programit Udhëtim Studimor për studentët e huaj			
	2.1.7 Krijimi një hapësire të veçantë dhe veprimtari			





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

	të dedikuara për diasporën shqiptare		
	<p>2.3.1 Të rritet numri i marrëveshjeve ndërinstitucionale në kuadër të programit Erasmus⁺ KA107 me vendet e BE.</p> <p>2.3.2 Të shtohet numri i kuotave të mobilitetit dalës për stafin akademik për trajnim, mësimdhënie, dhe realizimin e studimeve; kuotat për stafin administrativ dalës për trajnim, kuotat e mobilitetit hyrëse për stafin akademik për mësimdhënie ose trajnim; kuotat hyrëse për stafin administrativ për trajnim; të shtohen kuotat për</p>	<p>-Nr i lartë i shkëmbimeve hyrëse/dalëse të stafit akademik për mësimdhënie, trajnim dhe realizimin e studimeve.</p> <p>-Nr i lartë i shkëmbimeve hyrëse/dalëse të studentëve për studime ose internshipe</p> <p>-Përdorimi i fondit organizativ të alokuar nga universitetet partnere nga</p>	





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

	<p>mobilitetin dalës të studentëve për studime dhe internship; të shtohen kuotat për mobilitet hyrës për studentët e huaj për studime ose internship;</p> <p>2.3.4 Promovimi i mobilitetit të studentëve dhe stafit</p> <p>2.3.5 Nxitja e stafit akademik për të aplikuar</p> <p>2.3.6 Nxitja e studentëve ekselentë për të aplikuar</p> <p>2.3.7 Ofrimi i suportit në fakultet për studentët dhe stafin që do të shkojë në mobilitet apo stafin dhe studentët hyrës.</p>	<p>vendet e programit për aktivitete për stafin/studentët hyrës në UT</p> <p>- Krijimi i një programi për menaxhimin e marrëdhënieve ndërkombëtare “Mobility online” për një qendërzim më të mirë të informacioneve dhe të indikatorëve.</p> <p>-Javë informuese, aktivitete orientuese, ditë ndërkombëtare etj për studentët dhe stafin mbi rëndësinë,</p>		
--	---	---	--	--





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

		<p>impaktin dhe përfitimet e mobilitetit në nivel individual dhe institucional.</p> <p>-Krijimi i një grupi me studentë nga programet e studimit në UT për pritjen dhe shoqërizimin me studentët e huaj gjatë qëndrimit të tyre në UT.</p>		
--	--	--	--	--





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

2.3.1 Identifikimi dhe rritja e numrit të veprimtarive me karakter ndërkombëtar në FGJH	- Rritja e numrave të pjesëmarrjeve në Konferenca ndërkombëtare, kongreseve, Workshops, etj.		
	2.3.2 Rritja e bashkëpunimit të komunitetit universitar të FGJH-UT me publikun ndërkombëtar	-Rritja e pjesëmarrjes së pedagogëve dhe studentëve të huaj në veprimtaritë e organizuar nga UT -Krijimi i takimeve midis studentëve, personelit akademik vendas dhe atij ndërkombëtar (World coffee...)	





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

	2.4.1 Të identifikohen rrjetet prestigjioze evropiane dhe më gjerë	-Aderim në rrjete prestigjioze, aktivitete të gjurmueshme, pjesëmarrje aktive.		
	2.4.2 Përgatitja e procedurave administrative për anëtarësim	-Aplikime në projekte me partnerë pjesë e konsorciumeve		
	2.4.2 Ngritja e një fondi të dedikuar për pagesat e kuotizacionit	të rrjetit, organizime		
	2.4.3 Ngritja e një grupi pune në fakultet i cili është përgjegjës për implementimin e aktiviteteve që rrjedhin nga anëtarësimi në rrjetet e huaja	aktivitetesh të përbashkëta, etj.		
	2.5.1. Shpërndarja e informacioneve midis strukturave	-Krijimi i materialeve (dosjeve elektronike) për akses nga strukturat me		
	2.5.2 Qendërzimi i veprimeve në planin ndërkombëtar duke			





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

	<p>krijuar një adresë e-mail të dedikuar</p> <p>2.5.3. Informimi i komunitetit universitar në FGJH mbi rolin e Zyrës se Marrëdhënieve me Jashtë dhe Zyrës së projekteve</p>	<p>qëllim shpërndarjen e informacionit (marrëveshje, listat e profesorëve të ftuar, projekte në vazhdim apo që do të zhvillohen...)</p> <p>-Krijimi i nje adrese e-maili të dedikuar për qendërzimin dhe trajtimin e informacionit</p> <p>-Editimi i një informacioni mbi “kush bën çfarë?” dhe shpërndarja e tij drejt komunitetit universitar</p>		
--	---	---	--	--





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

	2.6.1 Njohja me aktivitetet që zhvillon/ofron zyra e marrëdhënieve ndërkombetare në UT dhe FGJH	-Krijimi i një letre informuese të brendshme për të njohur aktivitetet e zyrave të marrëdhënieve me jashtë		
	2.6.2. Komunikim më i mirë mbi rolin e referentit/ Koordinatorit të marrëdhënieve ndërkombëtare	-Organizimi i takimeve me koordinatorin e marrëdhënieve ndërkombëtare, publikimi i informacioneve mbi funksionet e tij		





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

	<p>2.7.1 Përforcimi i identitetit të FGJH-së së UT-Së</p> <p>2.7.2 Rritja e prezencës së UT-së jashtë shtetit</p>	<p>-Krijimi i faqes Web në gjuhën angleze, vitrinë e të FGJH-së së UT-Së jashtë shtetit</p> <p>-Publikimi i materialeve promovuese cilësore dhe të harmonizuara</p> <p>-Shtimi i vizibilitetit të publikimeve shkencore të FGJH-së në sajë të identifikimit të tyre</p> <p>-Pjesëmarrja e të FGJH-së së UT-Së në sallone studimi në vendet e</p>		
	<p>Trajnimi i vazhdueshëm dhe fuqizimi i strukturave të kërkimit shkencor, projekteve dhe marrëdhënieve me jashtë</p>			





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

		<p>rajonit (Kosovë, Maqedoni, Mal i zi, Bosnje-Hercegovinë)</p> <p>-Dërgimin e delegacioneve shqiptare jashtë për promovimin e studimeve në FGJH- UT</p> <p>-Evidentimi dhe referimi i të gjitha misioneve të kryera jashtë shtetit.</p>		
--	--	--	--	--





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



1.4.3. Objektivi Nr.3: Ndërkombëtarizimi i kërkimit shkencor;

Nr.	Veprime	Rezultate	Aktorët	Afatet
3.1 Fuqizimi i Kërkimit Shkencor Ndërkombëtar	<p>3.1.1 Nxitja e botimeve dhe referimeve të përbashkëta me kolegë nga universitetet partnere.</p> <p>Zhvillimi i sesioneve informative rreth procesit të publikimit dhe aksesit në revistat shkencore ndërkombëtare.</p> <p>Mbështetja financiare e stafit akademik për realizimin e projekteve kërkimore ndërkombëtare përmes granteve të vogla (pilot).</p> <p>Nxitja e qendrave kërkimore për zhvillimin e partneriteteve ndërkombëtare dhe realizimin e projekteve kërkimore në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë.</p>	<p>Numër i mirëpërcaktuar i botimeve dhe referimeve shkencore minimale për çdo staf akademik në bazë vjetore.</p>		





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

	<p>Mbështetja e stafit akademik gjatë procesit të botimit në revistat ndërkombëtare (p.sh., përmes programeve të mentorimit apo redaktimit të punimeve në gjuhë të huaj).</p> <p>Ofrimi i granteve kërkimore konkurruese, të cilat nxisin studiuesit të shqyrtojnë sfida të zhvillimit global.</p>			
	<p>3.1.2 Realizimi i ndryshimeve në aktet rregullatore përkatëse për mbështetjen e botimeve në revistat prestigjioze dhe pjesëmarrjen në konferenca të cituara ndërkombëtarisht.</p>	<p>Kuadër ligjor i mirëpërcaktuar për mbështetjen e botimeve dhe referimeve shkencore.</p>		
	<p>3.1.3 Promovimi i stafit akademik që realizon botime e referime, përkatësisht, revistat e konferencat e njohura ndërkombëtarisht dhe me një impakt faktor të lartë.</p>	<p>Staf i motivuar.</p>		





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

	3.1.4 Shtimi i vizibilitetit të publikimeve shkencore të FGJH-së në sajë të identifikimit të tyre	Krijimi i një platforme reklamimi të punimeve shkencore.		
	3.1.5 Ngritja e fondit financiar për mbështetje të studentëve të doktoratës dhe akademikët e angazhuar në kërkimin shkencor	Fond financiar në dispozicion të mbështetjes së kërkimit shkencor.		
	3.1.6 Intensifikimi i përpjekjeve për aplikime në projekte	Numër i lartë aplikimesh për projekte në thirrjet për aplikim kombëtare dhe të huaja nga donatorë vendas dhe të huaj.		
	3.1.7 Te nxitet rregullimi i praktikës për aplikim për programe twinnig me universitete të huaja.	Praktikë dhe procedura të përcaktuara qartë.		
	3.1.10 Të ndërtohet një Model Marrëveshjeje për Shërbimet e ofruara palëve të treta nga			





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

	Kërkuesit/Departamentet, i cili të marrë në konsideratë mënyrën e mbërritjes së fondeve të përfuara në departamentin përkatës, pagesën e stafit të përfshirë, dhe transparencën e procesit deri në shfaqjen online të shërbimeve si një kategori më vete e kërkimit shkencor të UT.			
	3.1.11 Trajnimi i stafit në nivel rektorati dhe fakulteti për shkrim projekti	Trajnime të realizuara nga ekspertë vendas apo të huaj të siguruar përmes fondeve të projekteve ose fondeve të dedikuara të universitetit.		
	3.1.12 Ngritja e strukturave të produktit shkencor (krijimi i laboratorëve etj)			
	3.1.13 Të realizohet akreditimi i laboratorëve shkencorë			





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

	3.1.14 Krijimi i një mjedisi miqësor dhe atraktiv për kërkimin dhe kërkuesit shkencor			
	3.1.15 Thithja e “trurit” për të bashkëpunuar në shkrimin e projekteve kërkimore e zhvillimore			
	3.1.16 Përfshirja e studentëve të huaj të doktoratës dhe akademikë të huaj si udhëheqës			
	3.1.17 Ofrimi i aksesit në biblioteka online për kërkuesit shkencorë dhe studentët e doktoratës	Akses në biblioteka prestigjioze online.		
	3.1.18 Akses në rrjetin ndërkombëtar të organizimit të konferencave etj			
	3.1.19 Përkthime të teksteve nga shqip në gjuhë të huaj dhe anasjelltas;			





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



1.4.4. Objektivi Nr.4: Krijimi dhe fuqizimi i rrjetit ndërkombëtar të FGJH - Alumni;

Nr.	Veprime	Rezultate	Aktorët	Afatet
4.1. Krijimi dhe fuqizimi i rrjetit ndërkombëtar të UT Alumni	4.1.1 Identifikimi dhe përgatitja e databazës për studentët të cilët punojnë jashtë vendit	Databazë e studentëve që punojnë jashtë vendit dhe janë diplomuar nga FGJH	Njësia kryesore Njësia Bazë Zyra e Marrëdhënieve me Publikun Zyra e MN, Erasmus +	1 vit
	4.1.2. Identifikimi dhe përgatitja e databazës për studentët të cilët kanë ndjekur një program studimi ndërkombëtar apo kanë zhvilluar një periudhë mobiliteti për studime apo internship	Databazë e studentëve që kanë zhvilluar një periudhë mobiliteti apo një program të plotë studimi në saj të programeve të përbashkëta të UT me partnerët ndërkombëtarë.		





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

	4.1.3 Promovimi i Rrjetit Alumni të studentëve ndërkombëtarë	Rrjet ALUMNI vizibël, i marketuar përmes kanaleve të ndryshme		
	4.1.4 Përcaktimi i stafit në fakultet për mbajtjen e komunikimit dhe menaxhimin e aktiviteteve, komunikimeve të rrjetit	Grup pune përgjegjës për mbarëvajtjen dhe mirëfunksionimin e rrjetit		





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

1.5. Treguesit dhe rezultatet e pritshme

- Reflektimi i dimensionit ndërkombëtar dhe evropian në të gjitha programet e studimit.
- Zhvillimi i një sërë kompetencash globale dhe ndërkulturore.
- Pasurimi i koleksionit të bibliotekës dhe mundësive të bibliotekës online.
- Ofrimi i programeve të përbashkëta me universitetet e huaja.
- Organizimi i shkollave verore.
- Rritja e numrit të internshipeve ndërkombëtare.
- Rritja e numrit të shkëmbimit të studentëve.
- Rritja e numrit të shkëmbimit të stafit akademik dhe administrativ.
- Një bazë të dhënash mbi shkëmbimet ndërkombëtare.
- Ristrukturimi i zyrës së marrëdhënieve ndërkombëtare dhe funksioni këshillues ndërkombëtar.
- Një listë e revistave të synuara me faktor impakti dhe e konferencave.
- Një bazë të dhënash për projektet kërkimore dhe partnerët kërkimore.
- Organizimi i konferencës ndërkombëtare çdo vit.
- Pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtare.
- Rritja e anëtarësisë institucionale dhe individuale në shoqata profesionale ndërkombëtare.
- Rritja e numrit të studentëve ndërkombëtarë që ndjekin programet e FGJH.
- Përdorimi i platformës mësimore online për veprimtari mësimore/kulturore me të huaj.
- Krijimi i një fryme dhe bashkësie ndërkombëtare studentore





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



KREU II. ANALIZË E SITUATËS SË NDËRKOMBËTARIZIMIT NË FGJH

Për të përcaktuar prioritetet dhe objektivat që dalin në kuadër të ndërkombëtarizimit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, nevojitet fillimisht kryerja e një analize të gjendjes aktuale në të cilën ndodhen shtyllat themelore ku mbështetet ndërkombëtarizimi: Bashkëpunimet me partnerë të huaj; projekte të përbashkëta kërkimore-shkencore me universitete të huaja; programe formimi të përbashkëta me universitete të huaja. Kjo analizë do të shtrihet në tri vitet e fundit. Analiza e gjendjes aktuale SWOT shërben për të matur në mënyrë të përafërt Pikat e forta, Pikat e dobëta, Mundësitë dhe Risqet.

2.1. Analizë e gjendjes aktuale - ANALIZA SWOT

Pikat e forta	Pikat e dobëta
<ul style="list-style-type: none">-Programe studimore në Gjuhë të Huaj-Cilësi e stafit mësimdhënës;-Laboratorë bashkëkohorë të interpretimit;-Struktura në nivel IAL-je dhe Njësie Kryesore për ndërkombëtarizim;-Marrëveshje ndërinstytucionale të nënshkruara në nivel IAL-je;-Numër i lartë i publikimeve shkencore	<ul style="list-style-type: none">-Prania e pakët e fakultetit në rrjetet kërkimore ndërkombëtare;-Ndërkombëtarizim i pakët i aktiviteteve arsimore. Marketing;-Mungesë e një buxheti të dedikuar për ndërkombëtarizimin;-Motivim i ulët i stafit, studentëve dhe studiuesve për të konkurruar në projekte ndërkombëtare;





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

nga stafi akademik; - Prani e stafit akademik ndërkombëtar;	-Mungesë e regjistrimeve aktuale të studentëve ndërkombëtare; -Mungesë e trajnimit të stafit për shkrim projekti; -Vështirësi ligjore për shpërblimin e kërkuesve shkencor në përfshirjen në projekte;
Oportunitetet/mundësitë	Risqet /Kërcënimet
-Programet evropiane (Erasmus+, Horizont 2020, EU for Innovation, etj); -Rritje e interesit të studentëve ndërkombëtarë për të studiuar në IAL shqiptare; -Zhvillim teknologjik; -Mbështetje e qeverisë;	-Niveli i lartë i konkurrencës në nivele kombëtare dhe ndërkombëtare -Vështirësi në ndërveprimin me kompani të ndryshme për projekte ndërkombëtare; - Brain drain; - Covid 19;





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



2.2. Analizë e situatës mbi bashkëpunimet me partnerë vendas dhe të huaj gjatë 3 viteve të fundit.

Gjatë tre viteve të fundit 2018-2021, Njësitë bazë të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja kanë vijuar bashkëpunimet me partnerë vendas dhe të huaj të cilët janë aktivë në sferën e arsimit të lartë dhe ose mbështesin organizimin e aktiviteteve që synojnë:

- rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe të produktit shkencor,
- ofrimin e trajnimeve të vazhdueshme,
- ofrimin e bursave kërkimore,
- zhvillimin e aktiviteteve sociale dhe kulturore,
- organizimin e leksioneve të hapura etj.

Personeli akademik i Departamenteve të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja prej vitesh merr pjesë në konferenca ndërkombëtare dhe botime në revista jashtë shtetit, në kongrese dhe konferenca ndërkombëtare ku kanë referuar e kanë promovuar punën shkencore; është pjesëmarrës në borde shkencore ndërkombëtare të revistave dhe konferencave.

Në këtë drejtim, partnerë kryesorë për Njësitë bazë të FGJH-së shfaqen universitetet e huaja, përfaqësitë diplomatike të atashuara në vendin tonë, organizmat, agjencitë apo fondet zhvillimore aktive në fushën e arsimit të lartë, zyrat rajonale të bashkëpunimit, etj.

Konkretisht:

- AUF – Agjencia Universitare Frankofone
- DAAD - Shërbimi Gjerman për Shkëmbime Akademike
- Instituti Goethe





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

- Aleanca Franceze në Shqipëri
- Instituti i Kulturës Italiane
- Fondacioni Onasios
- Instituti Junus Emre, Tiranë
- Fondacioni MARIF
- Biblioteka Kombëtare
- Qendra kombëtare e librit dhe e leximit
- Fondacioni AADF
- British Council in Albania
- American Council in Albania
- Instituti Konfuci
- Universiteti “Zoja e Këshillit të Mirë”, Qendra e Gjuhëve të Huaja
- Instituti Shtetëror i Marrëdhënieve Ndërkombëtare të Moskës
- Ambasada e Spanjës në Shqipëri
- Ambasada e Francës në Shqipëri
- Ambasada e Italisë në Shqipëri
- Ambasada Gjermane në Shqipëri
- Ambasada Amerikane në Shqipëri
- Ambasada e Greqisë në Shqipëri
- Ambasada e Rusisë në Shqipëri
- Ambasada e Polonisë në Shqipëri
- Ambasada e Bullgarisë në Shqipëri
- Ambasada e Turqisë në Shqipëri
- Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Shqipëri
- Ambasada e Mbretërisë së Arabisë Saudite në Shqipëri





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



Me ndihmën e tyre, janë zhvilluar një sërë aktivitete, të tilla si konferenca shkencore të përbashkëta apo në bashkëpunim me institucione të huaja:

Departamenti i Gjuhës Frënge ka zhvilluar një konferencë ndërkombëtare (Maj 2019) në bashkëpunim me Universitetin Aldo Moro të Barit, organizuar nga Prof. As. Dr Egla Gishti, Departamenti i Gjuhës Frënge. Po kështu, ka organizuar edhe një konferencë tjetër ndërkombëtare në Mars, 2021 *Quelle mise en valeur du patrimoine culturel par la communication?* Sa dhe nxirret në pah trashëgimia kulturore nëpërmjet komunikimit?

Në kuadër të bashkëpunimit me Shërbimin Gjerman për Shkëmbime Akademike (DAAD) **Departamenti i Gjuhës Gjermane** përfiton kryesisht për thithjen e bursave për studentë dhe pedagogë. Po kështu, DAAD ka prej shumë vitesh tashmë një lektor gjerman pranë departamentit të gjermanishtes, i cili asiston departamentin jo vetëm me mësimdhënie, por edhe në aktivitete të ndryshme akademike dhe kulturore. Viojnë bashkëpunime me Ambasadat e vendeve gjermanishtfolëse për aktivitete kulturore dhe për leksione të hapura. (Amb. Gjermane/Austriake/Zvicerane) P.Sh. Bashkëpunim i Departamentit të Gjuhës Gjermane me Bibliotekën Kombëtare, Institutin Goethe, Ambasadën Austriake dhe Ambasadën Gjermane: Klubi i leximit të autorëve gjermanofonë (takim i përmuajshëm me autorë dhe përkthyes të veprave të përkthyera nga gjermanishtja).

Dega e Gjuhës Ruse ka zhvilluar një konferencë Shkencore Ndërkombëtare (qershor, 2019) me temë: "Dimensionaliteti i Veprës së shkrimtarit rus A.S.Pushkin", Instituti Shtetëror i Marrëdhënieve Ndërkombëtare të Moskës bashkëpunoi me FGJH-në, me Degën e Gjuhës Ruse në një seminar njëditor online me temë: "**Kultura ruse dhe shqiptare në sytë e studentëve**", maj 2020;





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



Departamenti i Gjuhës Italiane ka zhvilluar një konferencë ndërkombëtare në muajin tetor 2021 "700 vjetori i Dantes" si edhe në vitin 2018 një Tavolinë e rrumbullakët ndërkombëtare për "Letërsinë e emigracionit".

2.3. Projekte të përbashkëta me universitete/institucione të huaja për çdo departament

Departamenti i Gjuhës Angleze, ka marrë pjesë në projektin e Bashkimit Evropian, me Titull të projektit: Erasmus+ Enhancement of the research potential contributing to further growth of the WB region/re@WBC.

Departamenti i Gjuhës Gjermane ka punuar për projekt-idenë e realizimit të një masteri mësuesie në Bashkëpunim me Institutin Goethe (Goethe Zentrum Tirana). Në këtë kuadër, janë shkëmbyer ide, janë zhvilluar disa takime për këtë qëllim dhe ende nuk është finalizuar.

Departamenti i Gjuhës Frënge ka marrë pjesë në projektet e mëposhtme kërkimore – shkencore, gjatë periudhës kohore 2018-2021:

1. Projekti "Quels outils linguistiques et stratégies de communication pour une valorisation du patrimoine culturel matériel et immatériel national?" Mjete Gjuhësore dhe strategji të komunikimit për vlerësimin e trashëgimisë kulturore kombëtare materiale dhe jo materiale, 2018-2021, të financuar nga AUF dhe Fondi kërkimor shkencor bullgar. Në këtë projekt, bashkëpunojnë së bashku me kolegët e Departamentit të Gjuhës Frënge, Universiteti i Tiranës edhe kolegë të Departamenteve përkatëse të Universitetit të Torinos, dhe Universitetit të Sofias – St Kliment Ohridski, Bullgari.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

2. Trajtimi automatik i gjuhëve në frëngjishten e aplikuar (Universiteti i Sorbonne Paris Nord, Universiteti i Artois dhe ai i Tunis, financuar nga AUF).
3. Projekti Formatheco 2020 Certifikime dhe teste zyrtare të gjuhës frënge: parime dhe organizimi, vlerësimi.
4. Projekti Formatheco 2020 Realizimi i guidave në frëngjisht për muzeun “Shtëpia e gjethëve” 1. Koordinatorë : Prof. Dr. Eldina Nasufi
5. Titulli i projektit: Consortium d’innovation pour construire des communautés participatives dans les universités d’Europe Centrale et Orientale.

Dega e Gjuhës Ruse në Departamentin e Gjuhëve Slavo-Ballkanike,

Projekti "CEEPUS", në të cilin bashkëpunohet me 14 institucione analoge nga Spanja, Portugalia, Belgjika, Austria etj. Numri i shkëmbimeve në sajë të këtij projekti është 3 studentë dhe 1 pedagogë dalës / 2 studentë dhe 1 pedagog hyrës: studentë/pedagoge dalës/ studentë pedagogë hyrës;

Numri i mobiliteteve të shkëmbimit të studentëve dalës në Departamente

Nr.	Viti Akademik	Departamenti i Gjuhës	Universiteti ku kanë shkuar për mobilitet
1	2019-2020	Frënge	St Kliment Ohridski, Bullgari
2	2018-2019	Frënge	St Kliment Ohridski, Bullgari
3	2019-2020	Frënge	Clermont Auvergne, Francë
4	2018-2019	Frënge	Las Palmas de Grand Canaria, Spanjë






REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

5	2018-2019	Frënge	La Sapienza, Itali
6	2017	Frënge	Clermont Auvergne, Francë
7	2017	Frënge	Clermont Auvergne, Francë
8	2018	Frënge	Clermont Auvergne, Francë
9	2018	Frënge	Clermont Auvergne, Francë
10	2019	Frënge	Clermont Auvergne, Francë
11	2019	Frënge	Clermont Auvergne, Francë
12	2021	Frënge	Clermont Auvergne, Francë
13	2021-2022	Frënge	Clermont Auvergne, Francë
14	2018-2021	Frënge	Haute école pédagogique de Lausanne, Zvicër, Projekti PEERS

Nr.	Viti Akademik	Gjuhë	Universiteti ku kanë shkuar për mobilitet
1	2018-2019	Gjermane	Universiteti i Saarland, Gjermani
2	2018-2019	Gjermane	Universiteti i Saarland, Gjermani
3	2018-2019	Gjermane	Universiteti i Grazit, Austri
4	2019-2020	Gjermane	Universiteti i Saarland, Gjermani
5	2019-2020	Gjermane	Universiteti i Humboldt, Gjermani






REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

6	2019-2020	Gjermane	Universiteti i Humboldt, Gjermani
7	2019-2020	Gjermane	Universiteti i Humboldt, Gjermani
8	2020-2021	Gjermane	Universiteti i Humboldt, Gjermani
9	2020-2021	Gjermane	Universiteti i Humboldt, Gjermani
10	2020-2021	Gjermane	Universiteti i Humboldt, Gjermani

Nr.	Viti Akademik	Gjuhë	Universiteti ku kanë shkuar për mobilitet
1	2018-2019	Spanjolle	Universitetin e Valladolid, Spanjë
2	2018-2019	Spanjolle	Universiteti Las Palmas De Gran Canaria, Spanjë
3	2018-2019	Spanjolle	Universiteti Las Palmas De Gran Canaria, Spanjë
4	2018-2019	Spanjolle	Universiteti Las Palmas De Gran Canaria, Spanjë
5	2018-2019	Spanjolle	Universiteti Las Palmas De Gran Canaria, Spanjë
6	2019-2020	Spanjolle	Universitetin e Almerias, Spanjë
7	2019-2020	Spanjolle	Universiteti Autonom i Madridit, Spanjë
8	2019-2020	Spanjolle	Universitetin e Valladolid, Spanjë
9	2019-2020	Spanjolle	Universitetin e Valladolid, Spanjë
10	2019-2020	Spanjolle	Universitetin e Valladolid, Spanjë





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

11	2019-2020	Spanjolle	Universitetin e Valladolid, Spanjë
12	2020-2021	Spanjolle	Universitetin e Valladolid, Spanjë
13	2020-2021	Spanjolle	Universitetin e Valladolid, Spanjë
14	2020-2021	Spanjolle	Universitetin e Almerias, Spanjë
15	2020-2021	Spanjolle	Universitetin e Almerias, Spanjë

Numri i mobiliteteve të shkëmbimeve të studentëve hyrës në Departamente

Viti Akademik	Departamenti Gjuhë	Universiteti nga kanë ardhur për mobilitet
2017	Frënge	Clermont Auvergne, Francë
2017	Frënge	Clermont Auvergne, Francë
2018	Frënge	Clermont Auvergne, Francë
2018	Frënge	Clermont Auvergne, Francë
2019	Frënge	Clermont Auvergne, Francë
2019	Frënge	Universiteti St Clement Ohridski, Bullgari
2019	Frënge	Clermont Auvergne, Francë
2019	Frënge	Clermont Auvergne, Francë
2020	Frënge	Clermont Auvergne, Francë





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

2018-2021	Frënge 15 studentë zviceranë të shpërndarë në vite	Haute école pédagogique de Lausanne, Zvicër, Projekti PEERS
2020-2021	Sllavo-Ballkanike Dega e Gjuhës Ruse	Universiteti Jugperëndimor i Blagoevgradit “Shën Ivan Rilski”, Bullgari;
2020-2021	Sllavo-Ballkanike Dega e Gjuhës Ruse	Universiteti Jugperëndimor i Blagoevgradit “Shën Ivan Rilski”, Bullgari;
2020-2021	Sllavo-Ballkanike Dega e Gjuhës Ruse	Universiteti Jugperëndimor i Blagoevgradit “Shën Ivan Rilski”, Bullgari;

Nr i mobiliteteve të shkëmbimit të pedagogëve të huaj hyrës në departamente

Nr.	Viti Akademik	Departamenti	Institucioni/shteti nga kanë ardhur për mobilitet
1	2019	Gjuhë Frënge	Universiteti St Clement Ohridski, Bullgari
2	2019	Gjuhë Frënge	Ekspert për komunikimin Turistik pranë KE
3	2015-2019	Gjuhë Gjermane	DAAD
4	2019-2021	Gjuhë Gjermane	DAAD
5	2018-2020	Gjuhë Gjermane	DAAD
6	2018-2019	Gjuhë Gjermane	Universiteti UJEP Usti nad Labem, Çeki





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

7	2018-2019	Gjuhë Gjermane	Itali, Torino
8	2018-2019	Gjuhë Spanjolle	Universiteti i Las Palmas De Gran Canaria, Spanjë
9	2020-2021	Departamenti i Gjuhëve Sllavo- Ballkanike	Universiteti "St. Cyril and St. Methodius" i Veliko Tarnovo, Bullgari;

Nr i mobiliteteve të shkëmbimit të pedagogëve dalës në departamente

Nr.	Viti Akademik	Departamenti	Universiteti ku kanë shkuar për mobilitet
1	2018-2019	Gjuhë Frënge	Universiteti i Bolonjës, Itali
2	2019	Gjuhë Frënge	Universiteti St Clement Ohridski, Bullgari
3	2019	Gjuhë Frënge	Universiteti St Clement Ohridski, Bullgari
4	2019	Gjuhë Frënge	Universiteti i Torinos, Itali
5	2019	Gjuhë Frënge	Universiteti i Torinos, Itali
6	2019	Gjuhë Frënge	Universiteti i Torinos, Itali
7	2019	Gjuhë Frënge	Clermont Auvergne, Itali
8.	2018-2019	Gjuhë Gjermane	Universiteti i Humboldt, Gjermani
9	2020-2021	Departamenti i Gjuhëve Sllavo-	Universiteti "St. Cyril and St. Methodius" i Veliko Tarnovo, Bullgari





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

		Ballkanike	
--	--	------------	--

2.4. Programe të formimit të përbashkëta me universitete të huaja.

Departamenti i gjuhës Gjermane po planifikon një marrëveshje partneriteti Erasmus+ me Universitetin UJEP Usti nad Labem, Çeki.

Departamenti i Gjuhës Frënge po planifikon një marrëveshje partneriteti Erasmus+ me Universitetin e Montpelliers-së në Francë si edhe me Universitetin e Poitiers në Francë.

Departamenti i gjuhës Greke po planifikon një marrëveshje partneriteti Erasmus+ me Universitetin e Janinës dhe me Ionnio të Korfuzit, Greqi.

2.5. Konstatime dhe përfundime

Në përfundim të analizave të pikave të mësipërme paraqesim vëzhgimet dhe analizat tona në lidhje me pikën 1.1. *Analizë e situatës së ndërkombëtarizimit në FGJH* ku krahas analizës së gjendjes aktuale nëpërmjet metodës SWOT, nga vëzhgimet e pikës 2.2. *Analizë e situatës mbi bashkëpunimet me partnerë të huaj gjatë tre viteve të fundit*, rezulton se Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ka një numër të konsiderueshëm partnerësh aktivë, mbështetës të veprimtarisë kërkimore, mësimdhënëse, shoqërore dhe kulturore që zhvillojnë Departamentet pjesë përbërëse e tij. Për shkak të zhvillimeve të fundit botërore në kuadër të pandemisë Covid-19, bashkëpunimet me këta partnerë nuk kanë qenë në masën e atyre përpara pandemisë.

Në lidhje me pikën 2.3. *Projekte të përbashkëta me universitete/institucione të huaja për çdo departament*, vërehet se ka një numër të caktuar projektsh kërkimore-shkencore të zhvilluara





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

nga disa njësi bazë. Rekomandohet që në këtë proces hartimi dhe zbatimi të projekteve të përbashkëta me partnerë të huaj, të përfshihen të gjitha Departamentet pjesë përbërëse e FGJH-së.

Konstatohet se ka interes të mjaftueshëm të studentëve për të marrë pjesë në programet e shkëmbimeve në kuadër të Erasmus + apo programeve të tjera. Rekomandohet që numri i programeve të shkëmbimit të mund të rritet duke realizuar bashkëpunime të reja me universitetet në evropiane të cilat janë vende të Programit, në programin e Bashkimit Evropian Erasmus+.

Në këtë kuadër, në marrëveshjet ndërinstitucionale të lidhura mes vendeve të Programit dhe vendit Partner, duhet synuar që të rritet numri i studentëve hyrës.

